


Të dhëna mbi të rinjtë e anketuar në 15 Bashki të vendit



Maj 2021

Ky Publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori), në kuadër të projektit “Leave No One Behind” (“Askush të mos Mbetet Pas”), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t’i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Përmbajtja e këtij Publikimi është përgjegjësi e Observatorit, në emër të Rrjetit të Organizatave “Zëri i të Rinjve”. Opinionet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, UN Albania apo SDC.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE




United Nations
ALBANIA



Leave
No One
Behind



Në kuadër të programit për zgjerimin e rrjetit “Zëri i të Rinjve”, koordinuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në partneritet me UNFPA Albania dhe në zbatim të projektit “Leave No One Behind” (“Askush të mos Mbetet Pas”) janë anketuar të rinjtë në lidhje me njohuritë e tyre mbi Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (SDGs), Shëndetin Seksual dhe Riprodhues (SRH), si edhe programet rinore të Bashkisë. Të anketuar ishin **929 vajza (62%) dhe 571 djem (38%)**.






15 Bashki

Shkodër, Roskovec, Belsh, Korçë, Pogradec, Cërrik, Durrës, Fier, Maliq, Krujë, Dibër, Lezhë, Përmet, Urë Vajguore, Shijak

Gjatë periudhës: 2017-2021




1500



të rinj (nga 15 Bashki)
të grupmoshës 14-29
vjeç janë anketuar në
vitet 2017-2021

Deklarata e
Angazhimeve për të
rinjtë u nënshkrua
nga Bashkia e
Tiranës në vitin 2015
dhe u monitorua në
vitin 2019




1 Të dhëna mbi njohuritë e të rinjve mbi:

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals – SDGs)

Shëndetin Seksual dhe Riprodhues (SHSR)

Programet dhe shërbimet e Bashkisë për të rinjtë



A - Njohuritë e të Rinjve mbi SDGs

1 në 10

të rinj kanë dëgjuar se çfarë janë SDGs.



55%

e të rinjve të anketuar janë shprehur se nuk janë përfshirë personalisht në arritjen e SDGs.



55%



70%

Shkolla dhe Interneti janë burimi i informacionit për të rinjtë për SDGs.

B - Njohuritë e të Rinjve mbi SHSR

1 në 7



të rinj nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.



78%

Shkolla (në 78% të rasteve) dhe **Interneti** (në 70% të rasteve) janë burimi më i shpeshtë i informacionit të përdorur për SHSR.




70%

1 në 10



të rinj (10%) shprehen se nuk mundën të flasin për këtë tematikë me prindërit ose prindërit nuk i'a lejojnë që të flasin.



65%

Shkolla (në 65% të rasteve) dhe **Interneti** (në 27% të rasteve) konsiderohen mjetet ideale për marrjen e informacionit për SHSR nga ana e të rinjve.



27%

C - Njohuritë e të rinjve mbi programet dhe shërbimet e Bashkisë për të rinjtë

Afërsisht 1 në 3 të rinj janë në dijeni të programeve/ prioriteteve të Bashkisë në lidhje me të rinjtë.




Portali online (në 31% të rasteve), Njoftimet publike (në 31% të rasteve) dhe Faqja zyrtare e Bashkisë (në 28% të rasteve) janë burimi i informacionit për të rinjtë për programet e Bashkisë për të rinjtë.

D - Programet më të preferuara që të rinjtë do të donin të përfitonin nga Bashkia


Aktivitetet sociale,
informuese,
ndërgjegjëse,
trajtime

Pjesëmarrje në
vendimmarrje/
këshill rinor/ forume
rinore, organizata të
shoqërisë civile




Aktivitetet
argëtuese dhe
sportive

Aktivitetet
mjedisore dhe
kulturore



Laborator,
komputera,
salla leximi


Aktivitetet dhe shërbime rinore
(përmes qendrës rinore,
punësim/ kurse profesionale,
arsimim, shëndetësi, kartë
rinore, e-shërbimet, bursat etj)



Sisteme
ngrohje

2 Buxheti për rininë

15 Plane veprimi dhe Buxheti për Rininë janë hartuar në nivel bashkie



Buxheti për rininë thekson nevojën e planifikimit dhe investimeve për rininë nga ana e Bashkisë në lidhje me:

Nxitjen dhe pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve në proceset dhe vendimmarrjet demokratike

Zbatimin e veprimeve të parashikuara Planin e Kujdesit Social të hartuar në disa Bashki të vendit në lidhje me nxitjen e punësimit të të rejave dhe të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës


Nxitjen e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete mjedisore

Nxitjen e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete artistike e kulturore

Nxitjen e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete edukuese shëndetësore

Nxitjen e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qe ndrueshëm (Sustainable Development Goals – SDGs)

3 Raporti monitorues i zbatimit të planit buxhetor për rininë në bashki



4 Raporte monitorues të zbatimit të planit buxhetor për rininë janë realizuar në nivel bashkie (Durrës, Përmet, Fier dhe Korçë).



Raporti monitorues vlerëson ecurinë e zbatimit të planit buxhetor për rininë në nivel lokal, por gjithashtu mat dhe vlerëson qasjen e ligjit të ri për rininë të zbatuar në politikat vendore.



4

Deklarata e angazhimeve me të rinjtë në Bashkinë e Tiranës



Nga monitorimi i kërkesave të të rinjve, sipas [Deklaratës së angazhimeve për të rinjtë](#), nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tr në vitin 2015, rezulton se niveli i arritjes është si më poshtë:

KËRKESA (në vitin 2015)	REALIZIMI (në vitin 2019)
Të trefishohet buxheti për rininë	Buxheti i Bashkisë Tiranë i alokuar për rininë është trefishuar (nga 1% në 3%)
Të nxitet sipërmarrja rinore	Konkurse për "Ide inovative". Programet e Start Up dhe "Të rinj dhe të reja drejt një profesioni".
Të hapen Qendra Rinore në zonat periferike.	Të gjitha bibliotekat janë kthyer në qendra multifunkionale me vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 35 dt 29.03.2018. Katër biblioteka lagjesh janë rikonstruktuar plotësisht dhe janë kthyer në Qendra multi-funkionale, duke filluar nga dhjetori 2017, si: Hamit Beqaj, Musine Kokalari, Petro Zheji dhe Misto Treska. Aktualisht kanë filluar punimet në bibliotekën e Njesisë nr 6 dhe 11 dhe në vijim do të fillojnë punimet në bibliotekën e Njesisë nr 2.
Të nxirret dhe fillojë të funksionojë Karta e të Rinjve dhe Studentit.	Studentët e universiteteve të Tiranës prej datës 27 Maj 2019 janë pajisur me kartën studentore, falë së cilës përfitojnë shërbime falas ose me kosto të reduktuar. Përveç platformës të ngritur on line kartaestudentit.al tanimë Aplikacioni Karta e Studentit shkarkohet si në Android ashtu edhe IOS.
Të krijohet Bordi Rinor Këshillimor i Bashkisë Tiranë	Bordi Rinor Këshillimor i krijuar në tetor 2015 dhe funksional që nga viti 2016. - Struktura, përbërja, anëtarësimi, funksionet, etj., janë strukturuar në rregulloren e funksionimit të tij, e cila është në proces përfundimi.

